



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Kuvendi Komunal Klinë

01 Nr. 06- 19976/25
Klinë, datë: 26.06.2025

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi i dhjetë buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027 në sallën e Kuvendit Komunal Klinë, me banorët e lagjëve të qytetit, i cili është mbajtur më datën 12 qershori 2024, në ora 17:00.


Të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtori i Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, Enver Berisha, drejtori i Arsimit, Qemajl Sejdija, drejtori i Urbanizmit, Enver Berisha, drejtori i Administratës, Binak Sylaj, drejtori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Lorenc Marleku, anëtarë të grupit punues, stafi i zyrës së kryetarit si dhe banorë të lagjëve të qytetit.

Materialin e diskutimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027, u shpërnda në formë fizike nga anëtarët e grupit punues.

Mbledhjen e hapi Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, i cili, pasi përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit, foli gjerësish mbi rëndësinë e këtyre takimeve buxhetore. Ai theksoi se këto takime janë të rregulluara nga ligjet në fuqi dhe se ato u japin qytetarëve të drejta të rëndësishme për hartimin sa më transparent dhe gjithëpërfshirës të buxhetit dhe investimeve të komunës.

Në fjalën e tij, Kryetari Elezaj vendosi theksin te rëndësia e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në këtë proces. Ai shpjegoi se përfshirja e qytetarëve në hartimin e buxhetit është jetike për të sigruar që resurset financiare të komunës të përdoren në mënyrë efektive dhe në përputhje me nevojat dhe priorititetet e komunitetit. Përfshirja e qytetarëve jo vetëm që rrit transparencën dhe llogaridhënien e qeverisjes lokale, por gjithashtu forcon besimin dhe bashkëpunimin midis qytetarëve dhe administratës komunale.

Kryetari Elezaj theksoi se këto takime ofrojnë një platformë ku qytetarët mund të shprehin idetë, shqetësimet dhe propozimet e tyre për projekte dhe investime të ardhshme. Ai inkurajoi të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktivë dhe konstruktivë në diskutime, duke nën vizuar se vetëm përmes pjesëmarrjes së gjerë dhe të larmishme mund të arrihet një buxhet që reflekton me të vërtetë interesat dhe nevojat e të gjithë komunitetit. Gjithashtu ai kërkoi që të diskutohet edhe për cilësinë, mbarëvajtjen e punimeve si dhe ndryshimet e bëra nga projektet e investuara më herët nëpër qytet e lagje të Klinës.



Sa i përket projekcioneve për vitet 2025-2027, e që sipas tij këto projeksione do të dalin nga kërkesat me takimet me qytetarë, ku kryetari theksoi se presim koment, pyetje, sugjerim e kërksa nga ana banorëve sepse mbahet procesverbali dhe të gjitha do të regjistrohen e do të trajton në raportin final të dëgjimeve, kështu hapi diskutimin me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

Diskutimin lidhur me këtë pikë e hapi Sahit Raci, banorë në qytet në rrugën “Isa Boletini”.

Sahit Raci, banorë në qytet Klinë: Përshëndetje kryetar, ju faleminderit për mundësin për këtë takim specifik kushtuar banorëve të lagjeve të qytetit. Si banorë në rrugën “Isa Boletini”, **kërkojë ulëse apo pushimore** tek pjesa e rregulluar tek lumim “Klina”. Gjithashtu, edhe **riparimin e rrugës “Mehdi Morina”**.

Më pas, më kërkesë ju dha fjala banorit Bajram Shala.

Bajram Shala, banorë në qytet Klinë: Përshëndetje kryetar, ju faleminderit për praninë tuaj. Kërkojë që në rrugën “Shaban Sadiku” dhe rrugën “Bedri Mustafa”, **të ndërrohet**

gypi i azbestit, duke pasur parasysh dëmët që shkaktohen nga përbajtja e tij e rrezikshme kimike.

Muhamet Gashi, banorë në qytet Klinë: Përshëndetje kryetar, si banues në objektin në qendër “Citadela”, afër objektit të Postës së Kosovës, rruga “Abedin Rexha”, në sheshin “Mujë Krasniqi”, **kërkojë renovimin e jashtëm të këtijë objekti**, pasi është nevojë e banuesve mirëpo njëherësh do të dukej bukur edhe për pamjen e qytetit.

Fjala me pas ju dha Ardian Qunit, përfaqësues i banorëve në objektin e banesave të kuqe, afër sheshit “Nënë Tereza” përballë KRMU “Ambientit”.

Ardian Quni, banorë në qytet Klinë: Përshëndetje për të gjithë ju, kryetar dhe ju drejtore të drejtive. Jam këtu si përfaqësues i banorëve në objektin e banesave të kuqe, afër sheshit “Nënë Tereza” përballë KRMU “Ambientit”. Unë në fakt e kam dorëzuar kërkesën më shkrim, më email, tek zyrtarja Vlora Tafili, ashtu siç thuhet edhe në njoftimin zyrtarë. Nuk do të shtoja më shumë, por shpresojë që kërkesa jonë të gjejë vend në priorititet buxhetore 2025-2027.

Milazim Raci, banorë në qytet Klinë: Përshëndetje për të gjithë ju, kryetar unë banojë tek ndërtesat afër sheshit “Faruk Elezaj”, kërkojë që tek parku i ri i ndërtuar me shtatorën e Faruk Elezajt, **të rregullohet edhe hapësira e jashtme aty tek oborret e ndërtesave**.

Kryetari Zenun Elezaj, përgjigjet: Po Milazim, siç jeni edhe ju personalisht i informuar, ne në bashkëpunim me Fondi Kosovar për Eficiencë të Energjisë, në bashkëfinancim do të bëjmë renovimin e jashtëm komplet të atyre objekteve, gjë që do të intervenojmë edhe në infrastrukturën e jashtme rrugore, në riparimin e saj.

Edmond Duhanaj, banorë në qytet Klinë: Përshëndetje për të gjithë, i nderuar kryetar kërojë që vitin e ardhshëm të **rritet buxheti në drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, në kodin për subvencione sepse edhe vetë si afarist që mirrem me kulturat bujqësore e shohë si të nevojshme që të investohet sa më shumë në këtë sektor.

Kryetari Zenun Elezaj: Po Edmond. Vitin e kaluar bësojë që kemi investuar mjaft në ndarjen e subvencionëve në formë të pajisjeve apo mekanizmave bujqësore, si sera, motokultivatorë, mbjellëse të grurit dhe misërit, mirëpo edhe vitet e ardhshme vetëm sa mendojmë me e rrit buxhetin sepse numri i aplikimit në thirrjet për subvencionim ka qenë jashtëzakonisht i madh. Andaj, edhe ne si qeverisje e kemi planifikuar rritjen në kategorinë subvencione.

Aka dikush tjetër që dëshironë të merr fjalën?

Nëse jo, atëherë e shpalli të mbyllur takimin sepse pas gjithë këtij diskutimi, unë nuk kam se çfarë të shtojë me shumë, por presim prape kërkesa çofshin me shkrim apo me email për të gjithë ata që nuk kanë pasur mundësinë me qenë sot të pranishëm, deri me datën 21 qershor.

Pas përfundimit të fazës së dëgjimeve publike buxhetore, propozimet e juaja do të merren në konsideratë duke u shqyrtuar në raportin e konsultimit publik nga anëtarë e grupit punues si dhe në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës konform dispozitave ligjore.

Ju falënderoj shumë çdonjërin këtu për pjesëmarrjen tuaj. Faleminderit shumë!

Takimi u mbyll në ora 17:57.

Në këtë takim kontribuan me pjesëmarrje 34 persona, më gjithësej gjashtë kërkesa të regjistruara.

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësev të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	30
Totali	30

Procesmbajtësja,

Vlora Tafili



A handwritten signature in blue ink is placed over a circular official stamp. The stamp is in blue ink and contains the text "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E KLINËS", "MINISTRU I KULTURËS", "REPUBLIC OF KOSOVO", and "MUNICIPALITY OF CLINIC". In the center of the stamp is a small emblem featuring a castle-like structure.